REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 11243-01349-00-2016 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-1897 i Vendimit (181)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përberë nga:

Majlinda ANDREA	**Kryesues**
Admir THANZA	**Anëtar**
Artan BROCI	**Anëtar**

Në seancën gjyqësore të datës 01.06.2016, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

PADITËS: **SHOQËRIA "2T" SH.P.K.**

I PADITUR: **SHOQËRIA "IREN ACQUA E GAS" (IAG), DEGA SHQIPËRI**

OBJEKTI: *Detyrimi i palës së paditur ti paguajë paditësit shumën prej 115.393 Euro si përmbushje detyrimi kontraktor, si dhe shpërblimi i dëmit në formën e fitimit të munguar të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit.*
Sigurimi i padisë duke vënë sekuestro konservative në llogaritë bankare të palës së paditur pranë bankave të nivelit të dytë deri në nivelin e kësaj shume.

BAZA LIGJORE: *Nenet 32, 153, 202 të K.Pr.Civile; Neni 79 e vijues i K.Civil, neni 419 e vijues, 445 e vijues, 698 e vijues i K.Civil.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2406, datë 03.03.2016, ka vendosur:

- *Të deklarojë mungesën e juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e kësaj kërkesë-padie me palë paditëse Shoqëria "2T" sh.p.k dhe palë të paditur Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri me objekt: "Detyrimi i palës së paditur të paguajë paditësit shumën prej 115.393 Euro si përmbushje detyrimi kontraktor, si dhe shpërblimi i dëmit në formën e fitimit të munguar të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit."*

Kundër vendimit nr.2406, datë 03.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur *ankim të veçantë* pala paditëse Shoqëria "2T" sh.p.k, që kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, duke pretenduar ndër të tjera se:

- *Nga përmbajtja e kontratës nuk ka asnjë diskutim në lidhje me kontratën. Pala e paditur e ka pranuar detyrimin, punën dhe faturat, si dhe ajo ka dorëzuar punën dhe faturat pranë shtetit shqiptar.*
- *Nuk asnjë diskutim në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate si parashikon neni 8 i kontratës.*
- *Në seancën gjyqësore pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë kundërshti në lidhje me njohjen e detyrimin si dhe të mohojë kryerjen e punës, apo diskutime si këto.*
- *Gjykata duhet të kishte dëgjuar argumentet e palëve dhe më pas të merrte vendim në lidhje me mungesën e juridiksionit si pasojë e klauzolës së arbitrazhit.*
- *Kërkojmë prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare dhe vazhdimin e gjykimit pranë kësaj gjykate.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Majlinda Andrea, dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, av.Gramoz Çela, që kërkoi prishjen e vendimit nr.2406, datë 03.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin po pranë kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit; përfaqësuesen e palës së paditur av.Valbona Gjoncari, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.2406, datë 03.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se shoqëria paditëse "2T" sh.p.k. është shoqëri shqiptare sipas ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ndërsa pala e paditur Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri, është regjistruar si Degë e shoqërisë së huaj (IAG S.p.A), sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

1.1. Këto dy shoqëri kanë hyrë në një marrëdhënie kontraktore me njëra tjetrën me "Kontratën e Nënkontraktimit (Contratto di subappalto)", duke rënë dakord për t'i lënë shoqërisë "2T" pjesë të aktiviteteve të Kontratës "Water production and storage rehabilition" që Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri, kishte me Ministrinë e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacioneve të Shqipërisë.

2. Ka rezultuar se me pretendimin e mospërmbushjes së detyrimit të pagesave sipas Kontratës së Nënkontraktimit, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Tiranë me një kërkesë-padi duke kërkuar detyrimi i palës së paditur të paguajë paditësit shumën prej 115.393 Euro si përmbushje detyrimi kontraktor, si dhe shpërblimi i dëmit në formën e fitimit të munguar të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit.

3. Në seancën gjyqësore të datës 27.01.2016, përfaqësuesi i palës së paditur ka kërkuar nxjerrjen nga juridiksioni gjyqësor i kësaj çështjeje në shqyrtim. Argumenti kryesor që ka paraqitur kjo palë është se palët ndërgjyqëse kanë parashikuar dhe pranuar që çdo mosmarrëveshje në lidhje me kontratën e nënkontraktimit, që palët kanë lidhur midis tyre, do të zgjidhen me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2406, datë 03.03.2016, ka vendosur:
"Të deklarojë mungesën e juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e

kësaj kërkesë-padie me palë paditëse Shoqëria "2T" sh.p.k dhe palë të paditur Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri me objekt: *'Detyrimi i palës së paditur të paguajë paditësit shumën prej 115.393 Euro si përmbushje detyrimi kontraktor, si dhe shpërblimi i dëmit në formën e fitimit të munguar të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit.'."*

4.1. Në marrjen e këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë arriti duke arsyetuar (ndër të tjera) se: *"... (omissis) ... Nga Kontrata e Nënkontraktimit lidhur midis Shoqëria "2T" sh.p.k dhe Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri, konkretisht në nenin 8 rezulton çdo mosmarrëveshje eventuale në lidhje me interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit. Në këtë kontratë palët kanë rënë dakord në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jo pranë gjykatave shqiptare. Por ato kanë parashikuar që çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit. Siç rezulton nga kjo kontratë nuk janë dhënë sqarime të detajuara në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjeve. Pala paditëse ka pretenduar që kjo mosmarrëveshje nuk futet në nenin 8 të Kontratës së Nënkontraktimit pasi kjo padi ka lidhje me fazën e ekzekutimit dhe jo mosmarrëveshje për përmbushjen e detyrimit kontraktor. Gjykata çmon se objekti i kësaj padie gjyqësore konkretisht "detyrimi i palës së paditur të paguajë paditësit shumën prej 115.393 euro si përmbushje detyrimi kontraktor si dhe shpërblimi i dëmit në formën e fitimit të munguar të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit" është brenda parashikimeve të nenit 8 Kontratës së Nënkontraktimit. Sipas kësaj kontrate çdo mosmarrëveshje eventuale në lidhje me interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura nga pala paditëse dhe pala e paditur rezulton se pretendimi i paraqitur nga pala e paditur është i mbështetur në ligj dhe në prova. Pala paditëse ka rënë dakord në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë Kontratë Nënkontraktimi sipas të cilës ajo ka dhënë pëlqimin e tyre duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave shqiptare për shqyrtimin. Në këtë dispozitë është përcaktuar Arbitrazhi Ndërkombëtar i Dhomës së Tregtisë së Parisit. Nga ana tjetër nuk mund të pranohet fakti që mosmarrëveshja të zgjidhet nga gjykata shqiptare me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit...(...)"*

5. Kundër vendimit Nr.2406, datë 03.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur *ankim të veçantë* pala paditëse Shoqëria "2T" sh.p.k, që kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkaqet e pretenduara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Ligji i zbatueshëm

6. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8687, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit", Konventa "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York, datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", në të cilat është parashikuar:

6.1. Neni 37 i K.Pr.Civile: *"Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj.*

Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë."

6.2. Neni 59 i K.Pr.Civile: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.*"

6.3. Neni 1 "Fusha e zbatimit të Konventës" i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961: *"Kjo Konventë zbatohet:*
a. për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshje e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme;
b. për procedurat dhe vendimet e arbitrazhit, që bazohen në marrëveshjet e parashikuara në paragrafin 1,a më sipër.
Për qëllimet e kësaj Konvente:
a.termi "Marrëveshje Arbitrazhi", do të thotë qoftë klauzolë arbitrazhi në kontratë ose në marrëveshje arbitrazhi, kontratë ose marrëveshje arbitrazhi, që janë nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash, telegramesh ose në një komunikim me teleshkrues dhe në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, ligjet e të cilëve nuk kërkojnë formën e shkruar për marrëveshjen e arbitazhit, çdo marrëveshje e përfunduar në format e lejuara
prej këtyre ligjeve;
b.termi "arbitrazh" do të thotë zgjidhja jo vetëm nga arbitrat e emëruar për do rast (arbitrazhi ad hoc),por edhe nga institucione të përhershme të arbitrazhit;
c.termi "seli" do të thotë vendndodhja e entit që ka përfunduar marrëveshjen e arbitrazhit."

6.4. Neni 2 "Zotësia e personave juridikë të së drejtës publike për t'iu drejtuar arbitrazhit" i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961: *"Në rastet e parashikuara në nenin 1, paragrafi i parë i kësaj Konvente, personat juridikë, të cilët ligji që zbatohet për to, i cilëson si "persona juridikë të së drejtës publike", kanë të drejtë të përfundojnë në mënyrë të vlefshme marrëveshje arbitrazhi. ..."*

6.5. Neni 4 "Organizimi i arbitrazhit" i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961: *"Palët në një marrëveshje arbitrazhi do të jenë të lirë t'ia nënshtrojnë marrëveshjet:*
a.një institucioni të përhershëm arbitrazhi; në këtë rast, procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregulloren e institucionit në fjalë; ..."

6.6. Neni 6 "Juridiksioni i gjykatës" i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961: *"Kundërshtimi për juridiksionin e gjykatës i bërë para gjykatës, që angazhohet nga çdonjëra palë e marrëveshjes së arbitrazhit, mbi bazën e faktit të ekzistencës së një marrëveshjeje arbitrazhi do të paraqitet nga i padituri para ose në të njëjtën kohë me paraqitjen e mbrojtjes në themel të tij, gjë që varet nëse ligji i gjykatës së angazhuar e konsideron këtë kundërshtim si pjesë të procedurës ose të themelit.*
2. Gjykata e shteteve kontraktuese, në marrjen e vendimit lidhur me ekzistencën ose vlefshmërinë e një marrëveshjeje arbitrazhi, do të shqyrtojë vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë duke iu referuar zotësisë juridike të palëve, sipas ligjit të tyre të zbatueshëm, si dhe lidhur me çështje të tjera si vijon:

sipas ligjit, të cilit palë i kanë nënshkruar marrëveshjen e tyre të arbitrazhit;
kur mungon një përcaktim për këtë, sipas ligjit ku do të jepet vendimi;
kur nuk tregohet ligji të cilit palët i kanë nënshkruar marrëveshjen dhe, kur në çastin kur çështja i është paraqitur gjykatës, vendi ku do të jepet vendim nuk është përcaktuar, sipas ligjit kompetent në bazë të rregullave të konfliktit të gjykatës të angazhuar për mosmarrëveshjen.
Gjykata, mundet, gjithashtu, të refuzojë njohjen e marrëveshjes së arbitrazhit në rast se sipas ligjit të vendit të tyre, mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet nga arbitrazhi. ...”

6.7. Neni 2 i Konventës “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, New York, datë 10.06.1958: *“1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh. 3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jo operative ose e pamundur për t'u zbatuar.”*

III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson

7. Se vendimi Nr.2406, datë 03.03.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është një vendim i argumentuar dhe bazuar ligjërisht dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se çështja e juridiksionit ka një rëndësi thelbësore procedurale, pasi mospërcaktimi i saktë i faktit nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në ndonjë juridiksion tjetër (siç është pretendimi në rastin konkret që mosmarrëveshja duhet t’i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit) lidhet me fatin e çështjes dhe zgjidhjen përfundimtare të saj, duke qenë se mosrespektimi i juridiksionit çon në prishjen e vendimit.

9. Referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile: “*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*”.

9.1. Kolegji Civil çmon se pavarësisht se kjo dispozitë flet për konfliktin midis juridiksionit administrativ dhe atij gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit të gjykatave të arbitrazhit (në referim edhe të nenit 37 të Kodit të Procedurës Civile).

9.2. Pra, çështja e juridiksionit mund të bëhet objekt shqyrtimi nga çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi duke analizuar dhe vendosur nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor apo, administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, etj. Këtë gjë gjykata mund ta bëjë *edhe kryesisht,* pasi çështja e juridiksionit

është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ.

9.3. Nga ana tjetër, rëndësia e përcaktimit nëse çështja i përket juridiksionit gjyqësor apo nëse çështja duhet referuar në arbitrazh nëse këtë kanë parashikuar vetë palët në kontratë, lidhet edhe me faktin se kur palët zgjedhin procedurën e arbitrazhit për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre, në të njëjtën kohë heqin dorë nga gjykimi i mosmarrëveshjeve nga organet gjyqësore (me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme).

10. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vlerësim të vendimit Nr.2406, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkaqeve të ankimit të veçantë, gjen të mbështetur në ligj konkluzionin e gjykatës së rrethit se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi klauzola e arbitrazhit (neni 8) parashikuar në Kontratën e Nënkontraktimit lidhur midis Shoqëria "2T" sh.p.k dhe Shoqëria "IREN Acqua e Gas" (IAG), Dega Shqipëri, është një klauzolë e vlefshme.

10.1.Konkretisht, palët ndërgjyqëse në Kontratën e lidhur mes tyre, në nenin 8 "Mosmarrëveshjet" kanë parashikuar se: *"Çdo mosmarrëveshje eventuale në lidhje me interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet me aplikimin e rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit."* Pra, palët ndërgjyqëse në momentin e hartimit dhe nënshkrimit të kontratës me këtë nen kanë shprehur vullnetin e tyre, që në rast të mos arritjes së zgjidhjes me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve *për interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e Kontratës*, ata do t'i drejtoheshin Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës së Tregtisë së Parisit.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se është e drejta e palëve në një kontratë (e lidhur mes një subjekti shqiptar dhe Degës së subjektit të huaj në Shqipëri) për t'ia nënshtruar mosmarrëveshjet në lidhje me kontratën një arbitrazhi ndërkombëtar. Kolegji Civil vlerëson të theksojë se, është e rëndësishme të kuptohet qartë që shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit. Kjo heqje dorë e palëve kontraktuese nga juridiksioni gjyqësor dhe dëshira për t'ia nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin mes tyre arbitrazhit bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për zgjidhjen e problemeve të krijuara mes tyre një zgjidhje më të shpejtë, më efektive dhe më pak të kushtueshme.

11.1. Edhe në rastin konkret, palët me vullnetin e tyre kanë përcaktuar arbitrazhin si mjeti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me kontratën, duke përjashtuar në këtë mënyrë juridiksionin e gjykatave shqiptare.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vëren se asnjë nga pretendimet e palës paditëse në ankimin e veçantë nuk i referohet nulitetit/pavlefshmërisë apo pamundësinë e zbatimit të klauzolës së arbitrazhit, por pretendimet lidhen me faktin se mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk ka lidhje me interpretimin e ekzekutimin e kontratës, duke qenë se pala e paditur e ka njohur detyrimin kundrejt palës paditëse. Kolegji Civil gjen të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se ky pretendim nuk qëndron. Pala paditëse i është drejtuar gjykatës pikërisht sepse pretendon mospagim të detyrimeve nga pala e paditur, objekti i padisë së saj është *"detyrimi i palës së paditur të paguajë paditësit shumën prej 115.393 euro si përmbushje detyrimi kontraktor si dhe shpërblimi i dëmit ... të ardhur si pasojë e vonesës në shlyerjen e detyrimit",* pra kërkimi i palës paditëse lidhet drejtpërdrejtë me ekzekutimin e kontratës dhe përfshihet brenda parashikimeve të nenit 8 Kontratës së Nënkontraktimit.

13. Nga ana tjetër, Kolegji Civil çmon të marrë në analizë parashikimet ligjore të brendshme lidhur me rregullimin e procedurave të arbitrazhit për parë vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit. Kodi i Procedurës Civile deri në 1 shtator 2013, parashikonte në Pjesën e II, Titulli IV, dispozita lidhur me arbitrazhin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Por me ligjin nr.122/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", në nenin 30, u parashikua që: *"Titulli IV i pjesës së dytë shfuqizohet"*, ndërsa në nenin 49 (fjalia e dytë) "Dispozita kalimtare" u parashikua që: *"Neni 30 i këtij ligji hyn në fuqi pas miratimit të ligjit për arbitrazhin"*.

13.1. Ndërkohë kjo dispozitë kalimtare është ndryshuar me ligjin nr.160/2013 "Për një ndryshim në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", ku nuk parashikohet asgjë lidhur me nenin 30 të ligjit nr.122/2013. Në këto kushte, rezulton se jemi përpara një ometimi ligjor, kapitulli mbi arbitrazhin që përmbante Kodi i Procedurës Civile është shfuqizuar dhe nga ana tjetër nuk është miratuar asnjë një rregullim tjetër specifik për të.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se në mungesë të një ligji të posaçëm mbi arbitrazhin ndërkombëtar çdo marrëveshje ndërkombëtare ose konventë e ratifikuar nga vendi ynë do të gjejë zbatim në rastin objekt gjykimi, si pjesë e së drejtës së brendshme dhe që ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to (referuar neneve 5, 116 e 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

15. Në këtë kuadër, Kolegji Civil i drejtohet Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8687, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit", e cila është e detyrueshme për zbatim dhe ka parashikuar një sërë rregullash të përgjithshme për organizimin, funksionimin e pranimin e marrëveshjeve të arbitrazhit mes personave fizikë dhe juridikë të vendeve të ndryshëm të Europës.

15.1. Në nenin 1 të saj, "Fusha e zbatimit të Konventës", përcaktohet (ndër të tjera) se: *"Kjo Konventë zbatohet: a. për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshje e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme; …"*. Në lexim të neneve 2 dhe 4, rezulton se palët janë të lira të lidhin një marrëveshje arbitrazhi (apo klauzolë) dhe janë të lira t'i drejtohet për këtë *(a)* një institucioni të përhershëm arbitrazhi (në këtë rast, procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregulloren e institucionit në fjalë) ose *(b)* një arbitrazhi *ad hoc*. Ndërsa në nenin 6 të Konventës, përcaktohet juridiksioni i gjykatës për të vlerësuar vlefshmërinë e klauzolës/marrëveshjes së arbitrazhit.

15.2. Edhe Konventa "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York, me datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", në nenin 2 parashikon se: *"1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një*

shkëmbim letrash ose telegramesh. 3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jo operative ose e pamundur për t'u zbatuar".

16. Në të tilla rrethana, Konventat e sipërcituara jo vetëm që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë si pjesë e rendit tonë juridik, por mbizotërojnë ndaj çdo parashikimi ligjor të së drejtës sonë të brendshme. Në këtë këndvështrim, në rastit në gjykim rezulton se palët kanë përcaktuar në kontratën e lidhur mes tyre *një klauzolë arbitrazhi*, sipas të cilës mosmarrëveshjet mes tyre do të shqyrtohen në një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar dhe pikërisht Arbitrazhi Ndërkombëtar i Dhomës së Tregtisë së Parisit. Kjo tregon qëllimin e qartë dhe të përbashkët të palëve për t'ju drejtuar arbitrazhit ndërkombëtar, e konkretisht një institucioni të përhershëm arbitrazhi me rregulla dhe procedura të mirëpërcaktuara (referuar nenit 4 të Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, në një rast të tillë, procedura e arbitrazhit zhvillohet në përputhje me rregulloren e institucionit në fjalë). Po ashtu, Kolegji Civil vëren se palët në këtë gjykim (posaçërisht pala paditëse/ankuese) nuk sollën asnjë argument mbi pavlefshmërinë apo pamundësinë e zbatimit të klauzolës së arbitrazhit që ato vetë kanë pranuar me marrëveshje mes tyre.

16.1. Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se klauzola e arbitrazhit lidhur mes palëve është e vlefshme dhe referimi i mosmarrëveshjes në shqyrtim arbitrazhit ndërkombëtar nuk bie ndesh as me nenin 37/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe as me parashikimet ligjore të Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar dhe Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar dhe të cilat përbëjnë burim legjislativ të detyrueshëm për zbatim. Ndaj vendimi Nr.2406, datë 03.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të lihet në fuqi si një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 59 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.2406, datë 03.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 01.06.2016

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S**
Artan BROCI	**Admir THANZA**	**Majlinda ANDREA**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi B.A.